

# Punishtja e Këpucëve të Abuelos

Nga Rei Goldrup

Bazuar në një ngjarje të vërtetë

*“Nuk është gjithmonë e lehtë të thuash ‘më vjen keq’”*  
(Children’s Songbook, f. 98).

Migeli hapi derën e punishtes së këpucëve të abuelos (gjyshit) të tij. Mbajti erën e lëkurës me të cilën punonte abueloja. Ishte një nga aromat e tij të parapëlqyera.

“Tjeta, abuelo!”

Abueloja ishte gjunjëzuar dhe po vizatonte formën e këmbës së një klienti në një copë letre. Ai nuk i ngrihti sytë. Dëgjimi i abuelos nuk ishte shumë i mirë.

Migeli u ul te banka e punës. Vështroi grumbujt e lëkurës së prerë. Përfytyroi se çfarë do të bënte abueloja me secilën prej tyre, duke përdorur çekiçin dhe pincat e tij.

Veglat i kujtuan Migelit diçka tjetër që e donte shumë. Abueloja i jepte atij gjithmonë një sheqerkë kurdoherë që Migeli ndihmonte për pastrimin.

Por Migeli kishte uri tani! Ai e dinte se nuk duhej të merrte një ëmbëlsirë pa pyetur, por dukej sikur abueloja do të ishte i zënë për njëfarë kohe. “Ndoshta nuk më duhet të pres”, mendoi Migeli.

Migeli u zgjat poshtë banakut që të merrte kavazin me sheqerka. Ishte plot me sheqerkën e tij të parapëlqyer – e ëmbël dhe pak djegëse nga pluhuri i specit djegës! Teksa e hapi, Migeli u ndje jo shumë rahat. Por sheqerka dukej kaq e shijshme. Ai nxitoi dhe e futi në gojë.

Shumë shpejt, klienti u largua. Abueloja mori një copë lëkurë dhe e zhyti me shpejtësi në pak ujë. Kjo ndihmonte që ta mbante lëkurën të butë dhe që të mund të punohej lehtë.

*“A e di, neve na duhet të jemi më shumë si kjo këpucë”, tha gjyshi.*



Migeli e gëlltiti pjesën e mbetur të sheqerkës sa më shpejt që mundi. Pastaj shkoi drejt abuelos.

“Përshëndetje!” tha abueloja me buzëqeshje. “Jam i kënaqur që erdhe të më shohësh.”

Migeli e përqafoi abuelon. Ai shpresonte që abueloja nuk do ta kuptonte se kishte ngrënë një sheqerkë. Migeli e largoi shqetësimin.

“Duket sikur je i zënë me punë sot”, tha Migeli, duke treguar me gisht grumbujt e lëkurës. “A ke nevojë për ndonjë ndihmë?”

“Sigurisht! A mund të ma japësh atë fije?”

Migeli u zgjat të merrte një fill të gjatë. Ai e tërhoqi me të dy duart. Ishte më rezistent se ç’dukej.

“Uau, qënka i fortë.”

Abueloja nënqeshi. “Duhet të jetë, që ta durojë konsumimin nga përdorimi i ashpër.” Abueloja e shkoi fillin përmes lëkurës. Pastaj ai mori atë pamje në fytyrë që mamá-ja nganjëherë e quante pamja e “abuelos së mençur”.

“A e di, na duhet të jemi më shumë si kjo këpucë”, tha abueloja duke tundur kokën.

Migeli ia nguli sytë lëkurës. “Ëëë. A duhet?”

“Po, vërtet. Ne duhet të qëndrojmë të fortë. Në atë mënyrë tundimet e Satanit nuk do të na thyejnë.”

Sheqerka e kuqe i shkrepëtiu Migelit në mendje. Ai e dinte se duhej t’i tregonte abuelos për të.

Abueloja mori një këpucë të vjetër nga rafti. “A e sheh këtë vrimë të madhe?”

Migeli ndoshta mund ta fuste dorën nëpër vrimë. “Po.”

“Kjo dikur ishte një vrimë e vogël që mund të ishte ndrequr lehtë. Por ata pritën dhe tani do të jetë shumë më e vështirë që ta rregullojmë. Zakonet e këqija dhe

zgjedhjet e këqija janë si ajo vrimë. Është më mirë t’i ndreqim herët.”

Abueloja e tundi sërish kokën dhe pamja e “abuelos së mençur” u shndërrua sërish në një buzëqeshje. Ata vazhduan të flisnin teksa abueloja punonte. Gjatë gjithë kohës, Migeli vazhdonte të mendonte për kallamin e kuq prej sheqeri.

Kur abueloja mbaroi, Migeli e ndihmoi atë të pastronte. Pastaj abueloja u zgjat të merrte kavazin e tij me sheqerka.

Më në fund, Migeli nuk mundi të duronte. “Unë mora një nga sheqerkat e tua!” tha ai befasi.

Abueloja e uli kavazin. “Çfarë the?”

Migeli i tregoi atij se e kishte marrë sheqerkën pa e pyetur. “Më vjen shumë keq, abuelo! Nuk do ta bëj më kurrë, të premtoj!”

Abueloja i dha Migelit një përqaftim të fortë. Migeli u ndje shumë më mirë.

“Faleminderit që ishe i ndershëm. Kjo është më e rëndësishme për mua se thuajse çdo gjë tjetër.”

Rrugës për në shtëpi, Migeli u ndje tamam si një nga palët e reja të këpucëve të abuelos. I fortë sa mundej dhe gati për jetën! ■

Autorja jeton në Jutë, SHBA.



## NJË NDJENJË E MIRË

Një ditë, unë dhe mami shkuam të paguanim faturën e ujit dhe burrit para nesh i ranë shumë para, por ai nuk e kuptoi. Unë nxitova dhe ia ktheva atij. Ai tha: “Faleminderit shumë” dhe tha se nuk mendonte që ndonjë fëmijë tjetër do ta bënte atë. Pata një ndjenjë aq të mirë pas kësaj. Do ta kujtoj gjithmonë atë ndjenjë të mirë.

Briana C., 9 vjeçe, Ajdaho, SHBA